



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë ___/___/2023

NJOFTIM

PËR

**SHPLLJEN E REKRUTIMIT PËR 2 (DY) SPECIALIST ME
KONTRATË TË PJESSHME PUNE**

Në kuadër të zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon të rekrutojë me kontrata të pjesshme pune (6 oree nee dite):

2 (dy) Specialist për promovimin e institucionit dhe mbështetjen e seksioneve të Avokatit të Popullit gjatë veprimtarisë së përditshme të tyre administrative.

Përshkrimi i punës për 2 (dy) Specialist për promovimin e institucionit dhe mbështetjen e seksioneve të Avokatit të Popullit gjatë veprimtarisë së përditshme të tyre administrative

- ✓ Mbështetje e vazhdueshme të seksioneve të Avokatit të Popullit gjatë ushtrimit të detyrave/veprimtarisë së përditshme të tyre administrative (gjatë trajtimit të ankesave, kthimeve të përgjigjeve, kontakteve me ankuesit apo institucionet publike etj).
- ✓ Ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, sipas një metodologjie të përcaktuar, duke bashkëpunuar dhe asistuar seksionet e institucionit, nëpërmjet ofrimit të të dhënave përkatëse për nivelin e zbatimit të tyre.
- ✓ Koordinimin e punës, për përgatitjen dhe dhënien e opinionëve për projekt-aktet që vijnë për mendim si dhe për raportimin në lidhje me zbatimin e konventave ndërkombëtare ku Shqipëria është palë apo dhe informacioneve/raportimeve që kërkohen nga organizatat dhe partnerët ndërkombëtare.

- ✓ Identifikimin dhe vënien në dispozicion të seksioneve, sipas fushave të së drejtës, të akteve/parimeve ndërkombëtare apo praktikave më të mira në fushën e të drejtave të njeriut.
- ✓ Mbështetje në organizimin e fushatave apo aktiviteteve promovuese, informuese apo sensibilizuese lidhur me të drejtat e njeriut si dhe rolin e institucionit në këtë drejtim, bazuar sidomos në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve

A. Për Specialistët për promovimin e institucionit dhe mbështetjen e seksioneve të Avokatit të Popullit gjatë veprimtarisë së përditshme të tyre administrative

Kandidatët që duan të aplikojnë për këtë pozicion, duhet të plotësojnë kriteret dhe procedurat e mëposhtme:

- Të zotërojnë Diplomë të nivelit “Master Profesional”, në Shkencat Juridike/Sociale. Edhe Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë
- Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune
- Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup
- Të kenë njohuri të mira të gjuhës Angleze
- Të kenë njohuri të mira kompjuterike

Orari dhe Periudha

Kandidatët fitues do të rekrutohen mbi bazën e një kontrate pune me kohë të pjesshme (6 orë në ditë), për një periudhë kohore 10 (dhjetë) mujore.

Orari ditor i punës do të jetë nga ora 90.00 – 15.00 me fleksibilitetin që në raste urgjente dhe të domosdoshme puna të vijojë edhe përtej fashës së orarit të punës të përcaktuar më sipër

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit:

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Letër motivimi
- Curriculum Vitae (CV)
- Kopje e diplomës
- Çertifikatë, dëshmi
- Kopje e librezës së punës
- Dëshmi të gjuhës së huaj (nëse ka)
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore

Aplikimet duhet të dërgohen në rrugë elektronike në adresën:

burimenjerezore@avokatipopullit.gov.al: ose në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Institucioni i Avokatit të Popullit
Blv. "Zhan D'Ark", nr 2, Tiranë
Shqipëri

Në vëmendje të Sektorit të Burimeve njerëzore

Afati

Aplikimet pranohen deri në datë 06/03/2023, ora 16.30. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumenteve vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.